

KËRKESË
Nr.3400/3, datë 30.5.2008

SHPLLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të shkollës 9-vjeçare, në lagjen “Bathore 6” Kamëz.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia Kamëz.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SHKOLLËS 9-VJEÇARE NË KAMËZ**

PRONARI	Z.K.	NR.PAS.	SIP.ARË M ²	ÇMIMI ARË LEKË/M ²	VLERA E TOKËS (LEKË)	VLERË TOTALE E SHPRONËSIMIT (LEKË)
RAMAZAN DEMIR NIKA	2066	189/24, 189/25	5000	626	3 130 000	3 130 000

Vlera totale e shpronësimit është 3 130 000 (tre milion e njëqind e tridhjetë mijë) lekë